

VENDIM
Nr. 337, datë 9.6.2021

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË ELBASAN, PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE ELBASAN, TË NJË PJESE TË PASURISË 5/38, ME EMËRTIMIN “ISH-ZYRAT E SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT”, ME VENDNDODHJE NË ZONËN KADASTRALE 8521, DHE TË PASURISË 15/43, ME EMËRTIMIN “ISH-DREJTORIA ARSIMORE ELBASAN”, ME VENDNDODHJE NË ZONËN KADASTRALE 8524, DHE PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 416, DATË 11.7.2007, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR
(ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 460, datë 30.7.2021)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 3, shkronja “a”, 5 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Elbasan, të katit përdhes dhe të katit të parë të pasurisë 5/38, me emërtimin “Ish-zyrat e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, me vendndodhje në zonën kadastrale 8521, dhe të pasurisë 15/43, me emërtimin “Ish-Drejtorja Arsimore Elbasan”, me vendndodhje në zonën kadastrale 8524, sipas formularëve, gjithsej 2 (dy) fletë, planimetrive dhe planeve të rilevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, me qëllim për t’u përdorur për ushtrimin e funksioneve administrative.

2. Pjesa e pasurisë 5/38, sipas formularit bashkëlidhur, hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme publike të miratuar me vendimin nr. 906, datë 19.12.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, për Shërbimin Kombëtar të Punësimit”, të ndryshuar.

3. Pasuritë e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohen listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike të miratuar me vendimin nr. 416, datë 11.7.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Elbasan, të qarkut të Elbasanit”, të ndryshuar.

4. Shfuqizuar.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Bashkia Elbasan dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



MIRATOHET



PLANIMETRIA E KATIT TE PARE

sipërfaqja e katit pare sip = 352 m²

Pergatiti: ING. BRUNO KORUMI

BRK

Prill, 2021

